

U MBAJT KONFERENCA “KU DO TË JETË ARSIMI I SHTIMES NË VITIN 2018?” - 29 shtator 2014

Komuna e Shtimes në bashkëpunim me Qendrën për Avancimin e Performancës së Arsimit (QAPA) në Prishtinë, mbajtën konferencën me temën: "Ku do të jetë arsimit i Shtimes në vitin 2018?". Të pranishëm në këtë konferencë ishin ministri i Infrastrukturës z. Fehmi Mujota, zëvendësministri I Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, z. Nehat Mustafa, prof. Halim Hyseni, drejtor i QAPA, përfaqësues nga kolegji "Mehmet Akif", kryetari i komunës së Shtimes z. Naim Ismajli, drejtorë shkollash, vijuesit e trajnimit "Lideri i shkollës së shekullit 21 " si dhe mysafirë të tjerë.

Shtime, 27 shtator 2014 – Komuna e Shtimes në bashkëpunim me Qendrën për Avancimin e Performancës së Arsimit (QAPA) në Prishtinë, mbajtën konferencën me temën: "Ku do të jetë arsimit i Shtimes në vitin 2018?". Të pranishëm në këtë konferencë ishin ministri i Infrastrukturës z. Fehmi Mujota, zëvendësministri I Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, z. Nehat Mustafa, prof. Halim Hyseni, drejtor i QAPA, përfaqësues nga kolegji "Mehmet Akif", kryetari i komunës së Shtimes z. Naim Ismajli, drejtorë shkollash, vijuesit e trajnimit "Lideri i shkollës së shekullit 21 " si dhe mysafirë të tjerë.

Sanije Bajraktari nga DKA e Shtimes mbajti një fjalim hyrës duke shtuar se janë mbledhur për t'i këmbyer idetë dhe planet për fëmijët dhe të ardhmën e vendit. “Ashtu siç kujdesemi për prindërit ne, njëjtë fëmijët tanë do të kujdesen për ne, kanë thënë më të moshuarit. Pleqët dhe fëmijët janë dy komponente të rëndësishme por këta të fundit janë ardhmëria e vendit. Jemi takuar për t'i hyrë një kantieri të madh por vital, i cili garanton ardhmërinë e ndritur. Fillimisht patëm guximin që ta konstatojmë gjendjen në arsim, e cila nuk është e kënaqshme, andaj duhet ndryshim rrënjësor. Kjo gjendje e vështirë nuk e prek vetëm Shtimen por tërë Kosovën. Tani i kemi identifikuar edhe forcat që do ta përgatisin arsimin për shkollën e shekullit 21”, ka përfunduar znj. Bajraktari.



Kryetari i komunës së Shtimes, z. Naim Ismajli, i cili ishte inicuesi kryesor për ndërtimin e një plani për zhvillimin e arsimit në komunën e Shtimes duke përshëndetur musafirët tha se Komuna e Shtimes është e vetëdijëshme se i duhet patjetër një arsim ndryshe andaj edhe sfidat janë para tyre. Pra, deri në vitin 2018 kërkohet një mobilizim i gjithëmbarshëm i të gjithë shtimjanëve për ngritjen e cilësisë në arsim. “Kjo konferencë shënon fundin e debatit njëmuor për Strategjinë Zhvillimore të Arsimit, e cila u ndihmua nga prof. Halim Hyseni dhe QAPA. Të gjithë vijuesit, 20 sosh të trajnuar, janë aftësuar për lider të shekullit 21, ndërkaq nga ky trajnim doli edhe plani strategjik si konstatim i gjendjes egzistuese dhe sfidat që na presin për zhvillimin dhe përparimin e arsimit. Po ashtu kanë dalur aktivitetet që do të zhvillohen me miqtë e shkollës sepse kjo sfidë është e përbashkët siç është vizion i përbashkët. Konferenca ka për synim thirrjen për veprim të përbashkët për implementim strategjik. Ky plan strategjik ka nxjerrë veprimet për secilën shkollë veç e veç. Unë si kryetar i komunës në emrin tim dhe të institucionit, ju garantoj se do të jemi mbështetës të fuqishëm të këtij plani si në aspektin moral, po ashtu edhe në atë material. Plani shumëkujt i duket ambicioz, madje edhe skeptik. Edhe 20 kandidatët vijues të trajnimit kur e morën modulën ishin të hamendur për implementimin, ndërsa tani plotësisht janë optimist se mund të bëhen ndryshime. I thërras të gjithë mësime të mësimdhënësit, që të bejnë me përkushtim punën e tyre si kërkesë e shekullit 21, thërras prindërit të ndihmojnë mësime të mësimdhënësit dhe nxënësit konform nivelit të shekullit 21, thërras të gjithë donatorët, Komunitetin e Biznesit që brenda mundësive ta mbështesin këtë projekt sepse një arsim cilësor është edhe kërkesë e tyre. Ky projekt i përbashkët, do të jetë model i transformimit të arsimit edhe për komunat tjera”, ka përfunduar

kryetari

Ismajli.



Sistemi i mësimit parauniversitar i Shtimes në fund të vitit shkollor 2018/19 do të jetë më i avancuari në rajon që i aftëson qytetarët e saj të nxënë gjatë gjithë jetës dhe kontribuoj që Shtimja të shndërrohet në një shtëpi të madhe të të nxënës dhe krijimit, ka thënë profesori Halim Hyseni, njëri ndër projektuesit e Planit për Zhvillimin e Arsimit në Shtime. Ai ju ka garantuar shtimjanëve për ndryshimet që do të ndodhin në arsim duke përmendur disa ide si ndryshimet në arsim duke thënë se egzistojnë dy forca në Shtime, njëra që mëton ta ndërrojë gjendjen dhe tjetra konservatore, e cila e mbronë status-quo. Ai, figurativisht ka bërë krahasimin e një treni të amortizuar dhe të tjetrit modern, i cili sipas tij ky i fundit ka filluar të lëvizë. Për ndërtimin e trenit të ri në arsim, profesori Hyseni ka thënë se po e ndihmon edhe politika dhe kryetari i komunës. “Në vitin 2018, Shtimja do ta ketë arsimin parauniversitar më të avancuar në Kosovë. Shtimja, gjatë këtyre 6 muajve ka filluar të lëvizë në përparimin e arsimit dhe ndryshimin e gjendjes. Këtë e mbështes duke i pasur parasysht faktet se Shtimja organizon e vetmja arsimin tërëditor në Kosovë. Shtimja, ka një diagnozë të saktë për të gjitha shkollat që mjerisht nuk e ka ende asnjë komunë në Kosovë“, tha profesori Hyseni. Ai më tej shtoi se kanë bërë hulumtime dhe si rezultat kanë nxjerrë një dokument që e vërteton gjendjen aktuale në arsimin e Shtimes. Në bazë të kësaj gjendjeje e kanë hartuar një Plan Zhvillimor për Arsimin gjatë viteve në vijim“. Kontribut të madh ka dhënë kryetari i komunës së Shtimes, për këtë plan, i cili është 5 vjeçar dhe thënë figurativisht jemi duke ndërtuar një shtëpi të re në arsim. Sistemi i arsimit është i vjetëruar dhe tradicional gjë që nuk i përgatit qytetarët të integrohen në trendet e zhvillimit të vendit. Vendet që kanë gjendje të rëndë ekonomike nuk investojnë në rezultate por në inpute. Ne nuk e kemi infrastrukturën ligjore që brenda shkollave të dominojnë trendet e avancuara. Të gjitha shkollat e komunës së Shtimes duhet t’i shndërrojmë në institucione të nxënës, kur sot në shekullin 21 fëmijë do të mësojë nga lindja deri në vdekje dhe Shtimja do të shndërrohet në shtëpi më të madhe të të nxënës e që pas disa dekadave të jetë një metropol. Qëllimi kryesor moral është që përfitimet e qytetarëve të Shtimes të dalin përfitues nga këto ndryshime në arsim.

Pra, ata duhet të jenë pronar të ndryshimeve. Qytetarët duhet të mobilizohen siç duhet të mobilizohen të gjitha institucionet arsimore sepse arsimit është industria më e madhe e Shtimit dhe e Kosovës, kur dihet fakti se pa arsim kombi nuk mund të jetë I avancuar. Indeksin e zhvillimit njerëzor e bënë arsimit, andaj duhet t'i zhvillojmë resurset dhe kapitalet njerëzore sepse përmes përmirimit të arsimit, ndikojmë në zhvillimin njerëzor. Arsimit sjell lumturi, begati madje ndihmon jetëgjatësinë e njerëzve. Të përmendim një fakt jetëgjatësia në Kosovë është 69 vjeç ndërsa në SHBA 110 vjet. Vitet e planifikuara të zhvillimit në Kosovë janë 9.4 % dhe duhet të bëjmë përpjekje maksimale që në vitin 2018 të arrijmë në 15.8 %. Sa i përket arsimit të qytetarëve të Shtimit, ka ngecje të madhe sepse 38 % të qytetarëve të Shtimit janë me arsim të ulët, 33% me arsim të mesëm, 22 % me arsim të lartë dhe vetëm 7% me fakultet“, ka shtuar prof. Hyseni. Ai më tej ka përmendur Planin për Zhvillimin e Arsimit, i cili sipas tij përmbanë 11 parime dhe siç tha ai është tejet i lumtur që kryetari i komunës ka shprehur gatishmëri për ta mbështetur këtë plan. Ai më tej ka përmendur 2 parime ndër 11 sa ka plani si interesin personal për ta sakrifikuar në interes të përgjithshëm dhe siç tha ai ata që nuk janë të gatshëm për këtë sakrificë e pengojnë implementimin e planit, ndërsa si parim tjetër përmendi punën ekipore. “Fazat e zbatimit të planit janë të qarta për të gjithë ne. Plani do të kalojë nëpër 4 faza duke i shndërruar shkollat e Shtimit në shkolla lëvizëse prej atyre tradicionale. Gjatë vitit 2015/2016 shkollat do të jenë miqësore për fëmijët. Më pastaj do të bëjmë shndërrimin e shkollave cilësore-produktive në shkolla organizata të fuqishme të të nxënës, gjenerimit të dijeve të reja, prodhimit, të cilat do të kontribuojnë që Shtimja të shndërrohet në shtëpi të madhe të të nxënës, të krijimit dhe të shkencës. Edukimi parashkollor do të ndryshojë, kemi punuar me fëmijët mesatar dhe jo me të tjerët deri më tani që domethënë i kemi viktimizuar fëmijët talentë. Po të kishim punuar me fëmijët e talentuar pavarësinë e Kosovës do ta kishim në vitin 1975. Deri më tani po na mungojnë dokumentet juridike që përcaktojnë rolin dhe detyrën e të gjithëve për shkollën”, ka përfunduar

prof. Halim Hyseni.



Ndërkaq, zëvendësministri i MASHT-it z. Nehat Mustafa, tha se infrastruktura ligjore nuk është pengesë që të avancohet arsimi. Nga viti 2015, tha Mustafa, arsimi parashkollorë, fillorë, i mesëm i ulët dhe i mesëm i lartë, do të jetë i obliguar dhe vitet e arsimit do të rriten në 13. “MASHT-i është në hap me kohën sa i përket politikës zhvillimore në arsim. Jemi në përfundim të investimeve të mëdha në infrastrukturën fizike të shkollave dhe vitin e ardhshëm do të angazhohemi në investimet për ngritjen profesionale të mësimitdhënësve. Kërkoj që prindërit ta monitorojnë punën e fëmijëve të tyre sepse ne i kemi të angazhuar 56 inspektorë për 1200 institucione arsimore, andaj monitorimi detaj mungon. E kisha lutur kryetarin e komunës së Shtimes z. Naim Ismajli që në Asociacionin e Komunave të Kosovës, të hapet debat për arsimin dhe kjo punë që po bëhet në Shtime të reflektojë pozitivisht në të gjitha komunat e Kosovës”, ka përfunduar Mustafa.

Në emër të drejtorit të Kolegjit “Mehmet Akif” në Banullë të Lipjanit, punimet e kësaj konference i ka përshëndetur z. Ali Kiliaki, i cili ka ofruar bashkëpunim të mëtejshëm reciprok në avancimin e arsimit.

Para prezantimit të punimeve kërkimore-shkencore nga mësimitdhënësit e Komunës së Shtimes, u hap ekspozita e fotografive të gjendjes së arsimit parauniversitar në Shtime sot dhe dukja e tyre deri në vitin 2018. Ndërkaq, 6 grupe mësimitdhënësish i prezantuan punimet kërkimore-shkencore. Në fund, kryetari i komunës z. Naim Ismajli, ndau certifikata për 20 vijuesit e trajnimit për “Lider të shkollës së shekullit 21” të organizuar nga QAPA nën përkujdesen e profesorit Halim Hyseni.